# Hadër Mevlani

BIBLIOTEKA
891-1
M 66



# Bërsi Poetike

**POEZI**

8 SH-1
M 66

HADER MEVLANI

# *Bërsi Poetike*

**Poezi**

57314

Redaktor : Aleksandër Çipa

Recezent : Preç Zogaj

Kopertina : Ing . Albert Lenja

Sponsorizues : Ing . A . Lenja ,
Ing . M. Cico ,
Ing . R . Mene

© Autori

Shtyp : Shtypshkronja " ABC "
**GJIROKASTËR**

# NË VEND TË PËRSHËNDETJES

Sot të gjithë përballemi me një valë të fuqishme informacioni . Gazeta , revista, libra vërshojnë nga të gjitha anët me pretendimin e bujshëm se në to është e vërteta ose ajo çka shqetëson shumicën. Në momentin kur mendon se ke krijuar një ide të qartë për një problem , nga një lexim i rastësishëm zbulon se idetë e tua për të janë të kufizuara, të mangëta dhe se shumica e konceptojnë krejt ndryshe .

Në lëmin e letërsisë botohen autorë të rinj , gjigandë dhe liliputë , poezi të qarta si dhe nga ato që duken të sofistikuara si teknikat kompjuterike .

Të gjendur përballë këtij realiteti ne sponsorizuesit ramë dakort që të mundësojmë botimin e poezive të z. Hadër . Ajo që na bashkon përveç profesionit është mendimi që kjo poezi është më afër nesh. Duke lexuar atë, ndjejmë konturet e maleve që rrethojnë qytetin tonë , kalldrëmet , rrugët e ngushta , vjetërsinë e tij . Ne s'mundemi ta spjegojmë se pse është më tërheqës një strehë çatije e vjetër, një fasadë ndërtese me dritare të shpeshta prej druri gjysëm të kalbur , një mur me gure plot myshk , një shtëpi e stilit të vjetër, një rrugë me kalldrëm që gjarpëron në lagjet e sipërme të qytetit , një plakë e kërrusur që çapitet ngadalë, por jemi të sigurt se në to ka diçka thelbësore që e bën jetën tonë të ketë kuptim.

Dhe pikërisht për këto gjëra flet poezia e kolegut tonë. Ajo e kundron realitetin që na rrethon nga një këndvështrim që për ne është i kuptueshëm , pamvarësisht se shpesh kontradiktor .

Detyrimisht del pyetja : kjo poezi e cila ju bën jehonë ndjenjave e mendimeve që për disa duken primitive duhet përkrahur apo duhet të lihet që të shuhet bashkë me poetin ? Ne jemi me alternativën e parë. Pamvarësisht se profesioni ynë na lidh me gjëra më konkrete dhe që i flasin më shumë mendjes se sa shpirtit, jemi të mendimit , se bota prandaj është e bukur sepse është e shumëllojshme dhe e mbushur me të papritura .

Së fundi , për të mos folur shumë dhe për t'ia dhënë fjalën poetit do t'i thoshnim që mos të presi që të gjithë ta falenderojnë dhe të mahniten nga poezitë e tij , dhe për poetët më të mëdhenj jo të gjithë janë në një mendje në vlerësimin e tyre .E rëndësishme është të flitet në një gjuhë universale të cilën kalimi i viteve mos ta bëjë të pakuptueshme

*Gjirokastër , Tetor 1998*

*SPONSORIZUESIT*

**Ing . A. Lenja**
**Ing . M.Cico**
**Ing . R. Mene**

# Fotografia

Tek kjo fotografi ju shoh të gjithëve
O shokët e mi të dikurshëm studentë,
I hedhur jam në krahët e rinisë sime ;
- Shushurini , ju plepa ndanë trasesë ! ...

... Ish' dit' e fundit e zborit me diell dhe erë
Ne bëmë stërvitjen komplekse në sulm ,
O shokët e mi, që m'u lodhët pakëz , atëherë
Dhe buzë trasesë, tek lumi , u ulëm .

E uroj me shpirt atë fotograf të pa emër
Që u ndodh aty e na bëri këtë fotografi
... Tani trenat andej si demonë çajnë erën
Dhe sirenat përshëndesin studentë të rinj ...

... Shikoj këtë fotografi dhe ju sjell ndërmend
dhe një herë ;
Si ta përshkruaj sejcilin, ç'mund të përmend ? ..
... Det' i kujtimeve me zhaurimë
Zajet në gjoks ç'm'i lëkund !..

*Arlindë , Irenë, Vjollcë, Filloretë,*
*Mondi , Skënder, Astrit, ...*
*...ç'do emër nga tuajt për mua është himn,*
*çdo shikim është një lëndinë e shtrenjtë ...*

*..........................................*
*Gaqi, Koletë, Adi, Rudinë,*
*Berti, Selman, Buljetë;*
*Janë, Sali, Nikollë, Elvirë,*
*Dezdemonë, Fatmirë, Virgjëreshë !...*

*v. 1986*

# Bukuroshja e autobuzit

Vajz' e panjohur n'autobuz,
Të shohin gjithë hutuar;
Se ç' bukuri në atë buzë,
- Mos fol hiç, të kuptuam!

...M'i paske flokët posi ari,
Të gjata si ujvarë,
Si lum ai që do t' të mari,
E bukurza e bardhë!

I pjekur bëhet kush të sheh
Dhe pakëz i menduar,
Dhe gaz' i tjetrit ne n'a nxeh,
Kur qesh i lumturuar...

- Ç' m'i paske sytë si ca burime
Që lezetojnë stinën,
Burojnë syresh lumenj shikimi
Zallishtes së fytyrës...

... Për bukuritë që kanë të tjerët
Këndoj dhe s'kam zili
Dhe ku i mjegullt, ku i kthjellët,
Po gjithë me mirësi,
E gjej unë gurrën që nuk shterret ,
Të njerëzve të mi ...

.................................

E buk'r' e autobuzit, moj
Të shohin gjithë nemitur,
Me naze—naze vetulla ,
Na urave me qerpikët !..

v. 1986

# Vrull pune ne klubin e komitetit ekzekutiv...

Në klubin e Komitetit,
-dendësia më e madhe e popullsisë në botë;
Në periudhë piku, njerëzit
S'kanë nga të rrotullohen ...

Në fillim ju shërben nënkryetarëve , shefave,...
Edhe pse mund të vijnë më vonë ;
Shitësja , - një grua e mençme ,
Që e di si duhet të proçedojë ...

... S'i kini parë zyrtarët potentë ,
Kur nguten për kos të leshtë , paçe koke ...
( Se s'ka për të gjithë, mbaron shpejt ;
Me përjashtim të disave , që ju rezervohet ...)

... Në klub shkoj sa më rrallë ,
Sepse mua , çunit të ri , që "s'ka.gjë në dorë ",
Më duhet të pres shumë minuta për një kafe ,
Edhe sikur shitësja të qe plaka ime ! ...

v. 1986

# Rruga Budi

Kur muzg' i natës zë e bie
Dhe dritat ndizen një nga një
Kam qejf të dal në rrugën "Budi"
Me ndonjë melodi nën zë.

Se kalamanët lozin në rrugicë
Dhe njëri—tjetrin ndjekin me gazmend,
Vijnë zëra , vjen erë gjellësh nga çatitë ,
Dhe mallin e shtëpisë se ç'ma nxjerr..

I dua shumë strehët që pikojnë;
Hardhitë që blerojnë si ndonjë mendim;
Arom'n e luleve që kundërmojnë
E dua shumë , siç dua poezinë ! ...

\- Njerëz të mirë që ktheheni nga puna
Unë ju shikoj në sy , por ju s'më njihni ...
Vajza të bukura , ju admiroj si ëndra ,
Në rrugën "Budi" jam gjithë këngë i tëri ! ...

v. 1981.

# Harmonika

Te shkolla jonë pedagogjike,
Mu përkarshi me kopshtin tim,
Ca tinguj të një harmonike
Më hidhnin tutje, në harim . . .

Prej lodrave me shokët e lagjes
Unë ikja heshtazi mënjanë
Dhe ulesha rrëzë lofatës
Që të dëgjoja zën'e asaj . . .

Ashtu sa herë muzgu më zinte
Dhe malet ngjyheshin në blu,
Kopeja plot me ëndrra bridhte
Në hapësirë s'di se ku . . .

Unë s'dija ç'qenë valset, aksionet,
Ç'quhej stërvitje dhe alarm,
Por harmonika plot me hove
Më merrte krahëve te saj! . . .

*Çdo vit përcillnim maturantë*
*Dhe s'kishte gjumë në konvikt,*
*vetëm kur yjtë shuheshin rradhë*
*Pushoje ti, fizarmonikë !...*

*.................................*

*Gjithë ato vajza me përparëse*
*Pas kaq vjetësh ç'bëjnë tani ?...*
*Në ç'zemra do kenë hyrë, në ç'pragje,*
*Në lindje, jug a në veri ?...*

*...............................*

*...U ktheva prapë në odën time*
*dhe në dritare ndjej një çast...*
*...sërishmi tinguj mandoline*
*dhe harmonikëzën e artë !*

*Nga rendin tinguj posi kuaj*
*Dhe ëndërroj prapë si fëmijë*
*Mbi shpinë të tyre përmalluar,*
*Në lindje, jug, e në veri !...*

# V. F - L. P

Mbi mure shtëpish, godinash të ndryshme,
Në një lartesi të vogël nga toka,
Kam parë të shkruar V. F - L. P
Me shkumës, thëngjill, a me tjegull...

...Atëherë ju poetë që shkruani kaq vjersha
Për dashurinë dhe fshatin socialist,
Pse ta kurseni qoftë dhe një strofë të vetme
Për motivin e feminisë ?...
Ndoshta i qortojnë prindërit, edukatorja, mësuesja
Që "prishin higjenën", që "s'kanë edukatë ",...
...Por unë dhe më shumë i dua këta "guerrilas "
të vegjël
Të etur për heroizma të mëdha ...

# Unë kam shumë vendlindje

Unë kam shumë vendlindje
Në atdheun tim
Dhe njerëz që më presin ngaherë
Edhe kur s'më dërgojnë letra
Dhe thirrje telefonike...

E si t'ua tregoj
Të gjitha lëndinat dhe fshatrat
Që më rregëtijnë në sy?...

...............................

Njëkohësisht,
A mund të jetosh në dy qytete
Dhe të njëjtën pasdite
Ta shohësh kudo?

Pavarësisht nga kjo,
Unë këndoj për çdo proskë dhe fije bari
Dhe për vashat që s'ikam puthur
Dhe për më të thjeshtin djalosh...

- Askush s'mund të më nënvleftësojë
Qoftë dhe me katundarin njeri,
Qoftë dhe atë më pak simpatikun
Dua, madje
Edhe erërat edhe zemërimet
Që dhe me to
Të dashuroj vendin tim

-Jepmëni mua
Forcë dhe njomësi , që të flas,
O baltrat e mia ! . . .

# Mbi varrin e ushtarit

( e përbotshme )

Mbi varrin e ushtarit nuk ka lule
Dhe nuk vajton askush, mbi kulm të tij;
E vetmja nënë që i bën pekule,
Është era me furtunë edhe me shi . . .

. . . Juve të gjithë i krehët kaçurrelat
Dhe dashuruat n'lulen e rinisë . . .
. . . Ushtari pat mikesha sharapnelat,
Dhe qytën puthi netëve në rrezik!
. . . Dhe para, dhe pas lufte pati paqe,
himne, mitingje ,.. duart u përpoqën ,..
. . . Ushtari s'u martua, s'lindi, s'plaket, . . .
Se plumbi çdo mundësi të tillë ja hoqi . . .

. . . Përmbi murranë t'ushtarit nuk ka lule;
Në brigje, lart, ku ra, nuk shkon njeri;
. . . Veç nënë e tija plakë, -një kërcure;
Lëndina, gërxhe, gjithë i shkon në sy,
Gjithkund ku toka ka ndonjë si rrudhë,
-Këtu, mendon, këtu do jetë im bir! ..

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .     . . .     . . . .

. . . Ju në pranverë,

-mendoni në acar ! ..

-Dhe prapë për 'të ,

-mendoni në acar ! ..

-Mos shkojnë ushtarë, kundër asnjë vatani,

Veç për lirinë e truallit amëtar!

-Se është e bukur lule e djalërisë,

Se është e fortë, plot muskuj e fjalëpakë,

Se fjalë të bukura shumë s'di të ujdisë,

Në vend të tyre - derdh lumenj me gjak ! ..

# Ninullë për Shefin

*Shefi im ninullat ka qejf,*
*Shefi im pi plot dëshirë,*
*Shefi im e di që është shef ;*
*Ai mendon se është shef i mirë . . .*

*Dhe ka qëlluar një shef i shëndoshë*
*Ai e ka arritur kuintalin*
*Gusha i varet ca poshtë*
*Dhe flokët si krifë kali*

*Shefi im është inxhinier i vjetër*
*S'do "teori!"dhe është "praktik" sa s'ka ,*
*Është i thjeshtë : ai psonis djathë me letër*
*Dhe vajguri me matara . . .*

*I mirë , se s'është i keq për të gjithë:*
*Ai femrat shumë rrallë i nxjerr në terren ;*
*E mënjanon me solemnitet kokën kur thotë:*
*S'dalin në rilevime gocat, sa të jem unë shef ! ..*

*( Se është xhentil i brishtë , ky shefi im ,*
*Megjithëse së jashtmi është dem ! )*

57314

Për punë shefi ka qejf të rinjtë :
Beqarët s'i sheh dot pa kapistër e samar
-Mjerë të urtët e të pamiqtë:
Viktimë e sulltanatit të tij shefor, janë !
Ç'gjë e lumtur, që duhet të jetë shefi - kaike
Se jam i sigurtë që s'i kujtohet asnjë formulë
Me përjashtim ,ndoshta ,të së mesmes arithmetike :
$a1 + a2 + a3 + \dots\dots\dots\dots\dots\dots\dots\dots\dots + an$
...........................................
X !

Ninullat, ninullat ka pasjon shefi im
-Shkurt, shkurt, sa më shkurt çdo punë ;
Se shefi harron, harron shumë o shpirt .
Harron emrat, fytyrat, ndodhitë, . . .
Shefi do gjumë !
.........................................

E zgjata pak ninullzën tënde ... shef
Se s'të zë gjumi kollaj, je sherre!
-fli, fli, ullullaj, marshala,
Tar-na-ne, tar-na- no, tar- nu - na

# Deas

Në konviktin e ri që ende mban erë llaç
Mora bustin e Deas dhe e vura në raft
Në shenjë dashurie dhe respekti për vajzat ...

Valët e flokëve si kurorë erërash?,
Bebëzat e syve - butrinte të kthjellët;
Mendime të bukura më zgjon ngahera
Dea, e vetmja vajzë në konviktin e djemve...

Kur vijat e fundit shënoj mbi projekt,
Mesnata poshtë sysh le harqe të zbehtë;
I lodhur ngre kokën dhe Dea më sheh
Me një qetësi të bardhë, të mermertë ...

Vajzë ilire, hyjneshë e bukur,
Unë jam kalorës i ri, shpatëndritur !..

# Pyes njerëzit në vjeshtë

A mundemi ne vallë të tregojmë
Se ç'fjalë thonë retë trëndafili
Sipër plepishtes s'artë tek shtegtojnë,
Kur muzgut kthen stërqoka në shtëpi?..

Dhe lum' i kaltër zallit i ka hije
Me gjuhë cironkash diç i mërmëril ...
-Lumenj; ju kini urulle dashurie,
Me mallin tuaj breni dhe shkëmbinjtë !

... Dhe një djalosh parcelash rrugë pa rrugë
Në duar mban dy pjata gjellë të nxehtë
Për traktoristin tej diku në fushë,
Ku mbillet bukë e re ...

Dardhishtë, pjeshkore, tejembanë skuqur
Si yje, qiej hurmash vezullojnë ...
Puntorë kthejnë nga fusha ngjyrë-purpur,
Për në stacion nxitojnë.

Kush malet me kodrinat e argjendta ?!
- Aty kanë festë çdo mbrëmje fise zogjsh . . .
. . . Si telat elektrikë më nisen ëndrrat
Gjer tej në horizont . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Dhe unë , kaq mrekulluar s'do të heshtja
As para qindra vajzave perri ,
Hokverdha , e Bukur 'e dheut , vjeshta ,
Fëmijë je ti përherë - dhe unë fëmijë . . .

- Tja puthim supet e zbuluar , shokë
Pa vjeshta s'pikturohet , s'njeh kornizë;
Pose me drita , ngjyra , ç'ka kjo tokë
Çdoças' ripërtërihet dhe na prin . . .

# Ty të mbuluan fletët moj lëndinë

. . . *Ty të mbuluan fletët, moj lëndinë ;*
*E verdhë - gunë gunë e tyre - tejpërtej . . .*
*Dhe qukapiku , kujton fëmijërinë ,*
*Duke shëtitur vetëm në zabel . . .*

*Një vidh i zi - qëndron fisnik , i heshtur*
*Dhe togje harabelash mban mbi shpinë, . . .*
*Përmbi një mur të gjelbër kulpërveshur ,*
*Një çërr - lan sytë e vegjël , me pak brymë ! . . .*

*Pa fik ' i verdhë dremitka pa u ndier ,*
*Dhe kumbulla , lofata , po ashtu . . .*
*Frullizë' e ftohtë - përzier me pak diell ,*
*Rrëzojnë fletët e mbetura diku . . .*

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

*Ty të mbuluan fletët . moj lëndinë ,*
*Ja gunë' e verdhë e tyre - tejpërtej .*
*Ky qukapiku - ç'vajton fëmijërinë*
*Duke shëtitur vetëm në zabel ! !*

# Eskiz për një mbrëmje

Atë mbrëmje,
Kur për herë të fundit,
prapë s'më erdhe;
Duart në xhepa,
Në rrugë,
Shumë cigare ndeza . . .
-Si është e mundur: s'na përkasin,
gjërat që më shumë se kushdo,
i meritojmë . . .

Sytë i humba
në mbrëmjen e thellë . . .
[illegible]ila [illegible]ë të [illegible]inte
di n[illegible] dëb[illegible]ra .

1989

# Ikja

. . . As më beohet që po ikën,
Kështu, e bukur si një muzg;
-një drithërimë dritash të brishta,
si yje në qiellin e bruztë . . .

. . . Tani s'besoj as që ke ardhur
Më parë, . . . sikur s'të preka kurrë;
- Pranverë e marrë,
- po unë s'u çmalla;
Më ike si ëndërr në gjumë . . .

. . . Gjurmët e tua ngrejnë pluhur
Tek ikën,
- si në shkretëtirë,
Furtuna rëre duke shkundur,
Më kthejnë në një dunë harrimi ! . . .

v. 1989

# Vogëlsira . . .

-Djalë i ri beqar,
Në shoqërinë e shefave të tu,
- ç'kombinim i keq,
Se në klub paguan shpesh . . .

v. 1988

# O Francë, ti je një Atdhe . . .

Një atdhe je ti Francë,
Ç'kërkojmë më tepër të jesh ?! . . .
. . . Ti barrikadsja e parë,
Dikur na ngrite peshë . . .

. . . S'më pëlqen ky Parisi i sotëm,
Jo për faktin se s'kam qenë në Paris,
Po ka një bukuri të pasosur,
Gjer në kufijtë e marrëzisë . . .

Të jesh i bukur, i bukur,
Velëm sharmantë, sharmantë; .
Po gijotinat, u ndryshkën
Kudo, përgjithmonë, Francë ?! . . .

Dt. 28.12.1990

# Sot kam ditëlindjen

*Sot kam ditëlindjen*
*Mbush njëzetenëntë vjeç,*
*Pa gëzime*
*Dhe pa lekë në xhep !...*

*Sot është ditë shiu,*
*Ditë dhjetori e rëndomtë :*
*Ditëlindjen s'ja them njeriu*
*Nga frika se mos ma festojnë!...*

*Dt. 28.12.1990*

# Dita kur u ndava përfundimisht me të dashurën...

...Shkëlqente Troja me të gjitha humbjet
Atë natë në sytë e tu ;
Histe Egjypti me të gjitha mumjet, ...
Veç ti heshtje si kërcu !...

.........................................

Kravguar ...
- Qysh kështu, prej motesh,
Prerë i patëm fatet me qamet ?!...
...Kohë më parë Hekuba derdhi lotët,
- Ty të dridhet mjekra e mermertë !...

v 1990

# Ndanë udhe u shtriva

I lodhur u ndjeva,
Dhe u shtriva në brinjë,
Thashë të hesht,
Të hesht gjatë . . .

-çohu të ecësh !
-plepat më fëshfërinë,
-çohu të ecësh !
-më tha toka me vlagë . . .

- Po më lini,
i thashë lëndinës
dhe mbretërisë së insekteve;
nuk e shihni sa i heshtur jam,
për të qënë i qeshur ?! . . .

. . . Po qukapikët çukitnin me padurim.
S'donin harabelat të ma firmosnin
fletë – heshtjen . . .

Dhelprat për një çast e lanë mënjanë
dinakërinë.
Ujku i murrmë tha : s'po e sulmoj
as unë sot kopenë e kecave ! . . .

As xixëllonjat,
As luleulet,
As prilja,
As harrimet,
Vendimin s'ma përshëndetën;
Por : — çohu të ecësh ! . . .

-çohu të ecësh,
çohu të ecësh,
o njeri i ndershëm ! . . .

-çohu, çohu, gjersa janë në këmbë dhe ecin
njerëz më pak nga ty , të mirë . . .
-Të lodhesh ti, që je më i sinqerti ? '
-Ti të mërzitesh, që shpirtin ke bu[illegible] :
Më je si agim — dhe t[illegible] hes[illegible]h ?

. . . Gjersa rrojnë shend e verë
Plot njerëz të liq.
o djalë i mirë,
çohu, rrugën e ndiq ! . . .

Dhe një,
Dhe dy,
dhe tre famfara të heshtjes,
Mbyti në hon të urrejtjes !
Bashkohu me lumin e ecjes ;
Dhe i lumtur n'mos qofsh,
- prapë të ecësh ! . . .
. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

. . . Se rruga të pjek, o i vogël,
Në rrugë shumë gjëra kupton,
Kushdo, që s'do ta ulë kokën,
Krugëton ! . . .

v. 1990

## Pikëllim . . .

Mua më bolojnë vetëm
Vjershat " e lehta ", " limonadat " . . .

. . . Më i ndershëm se unë më duket kamarjeri,
Edhe kur pranon bakshish ! . . .

Dt. 25. 10. 1990

# Gjyshja ime

*Gjyshja ime e moçme,*
*Është si një libër me poezi brilante,*
*Që qindra redaktorë cmirëzinj,*
*Ja "krasitën", ja shkurtuan,*
*Vargjet e "tepërt", "ujrat", "lulkat",...*
*Dhe tani s'mund t'i heqin më asnjë fjalë,*
*Asnjë gërmë,*
*Sepse çdo tingull të mrekullon...*

*...- Gërmituni sa të doni,*
*Zogori redaktorësh;*
*Gjyshja ime e vogël,*
*U katandis,*
*Një grusht me poezi brilante!...*

*Dt. 9.11.1990*

# Suva

*Suva, suva, suva;*
*Suva të murme të shtëpisë sime,*
*Bërë nga ati im me dy duar të mëdha*
*Dhe trup të vogël- një thërrime !...*

*v. 1991*

## Unë jam djalosh i poezisë...

Unë jam djalosh i poezisë
S'e luan topi fare,
S'jam sorrollop me balakçinjtë,
Se s'kam marë honorare . . .

Muzën e kam mikeshë për shpirt
Se nuk më ka braktisur;
Braktisin gratë, shtetet, miqtë, . . .
Braktis dhe . . . vetë braktisja ! . . .

Unë jam djalosh i poezisë,
Askush s'ma mohon dot;
Kam njëzet vjetë që shkaravis
Dhe s'kam botuar strofë! . . .

Se vjershat i sajoj siç dua;
Siç më thotë shpirti im;
Poshtë normat-u çfarostë me sua
Kritiku më i mirë ! . . .

Do mbetem djalë i poezisë
Dhe në më dalçin thinja,
Kurrë s'do t'i dua qeveritë,
Sadoqofshin të mira ! . . .

Dje s'më botonin se s'lëvdoja,
Sot s'më botojnë se nuk shaj . . .
Të mundurit do vjersha ime,
Më tepër se çdo fitimtar ! . . .

Dhe nga gjithë ndjenjat njerëzore
Trishtimin quaj më fisnik,
Veç poezisë i përgjërohem
Se veç ajo nuk më braktis !

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .
Unë jam djalosh i poezisë
S'e luan topi fare
Me ca si vetja llomotis
Për qejf ; s'pres honorare ! . . .

Dt. 29.04.1991

## Gomarët e fshatit bënë festë...

Gomarët e fshatit bënë festë
Se vdiq samarxhiu, dhe thanë ;
-Shpëtuam, tanimë s'do ngrëmë peshë;
Në fshat s'ka usta për samarë . . .-

...............................................

Veçse, ndër veshgjatët, më plaku,
- Ta marim, tha, shtruar, ngadalë ;
Se thanë, do vënë Çome allçakun,
Që dhogat t'i vë pa stromë fare !! . . .-

Dt. 25.05.1991

## Unë e di :
## Do më kujtosh e përmalluar

Unë e di : do më kujtosh e përmalluar
Dhe do të derdhësh lotë si [illegible]shiu
Bie shi mbi rrugën e pashtruar
Nëpër një mëhallë të shpirtit tim

Ti që brodhe visesh të pasjonit
Dhe buqeta lulesh mblodhe plot;
Ndoshta gjete gjithçka që kërkove,
Por gjithçka s'e gjete, sidoqoftë ! . . .

Mblidhi manushaqet, luleborет,
Vjollcat, trëndafilin që harlis, . . .
.. Nëpër shtegun tim, aq u vonove,
Sa s'do mund të vish, se tash u ngrys ! . . .

.. Unë e di : do më kujtosh e batërdisur,
Se gjithçka e gjete, por sërish
Do të duket vetja e braktisur,
Gjersa shpirtin tim askush s'e kish ! . . .

Dt. 29.04.1991

# Jam shkatërrimtar i dashurive te mia ...

Jam shkatërrimtar i dashurive të mia:
Pa mëshirë më duhet t'i vras ;
Se më ngrohin më shumë duke qenë nostalgjira,
Më rrojnë më shumë, duke qenë . . . të vrara ! . . .

Me zemër të vrarë, i vras dashuritë;
Siç bëni dhe ju-natyrisht, s'bëhet ndryshe . . .
Vetëm se unë, s'kam turp, as frikë,
Që vdekjen e tyre ta shpall me afishe ! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Jam shkatërrimtar i dashurive të mia,
- Braktisës pa fre, pa cak . . .
I zëvendësueshëm në 'to,
-po të rrija,
Shpirtin do ta ndjeja batak ! . . .

v. 1991

# Troja

Kush është i drejtë-
    është një Trojë,
Dhe sot, dhe jetë e mot...
Kush është i ndershëm – është Trojë;
Dhe Troja është lot!...

...Të gjithë e kanë dashur Trojën;
Edhe të liqtë për 'të janë trishtuar;
Madje dhe varrmihtësit e saj,
Të penduar i kënduan!...

..............................................

Por asgjë s'mund ta ringjallë,
Trojën; askush s'mund ta zgjojë,...
...Për Trojën ka kaq mall,
Pikërisht se është... Trojë!...

Dt. 2.05.1991

# Motiv i moçëm dasme

Unë do bëhem nuse
Të viç të më shoç,
Falëmë të lutem,
Të mos më qortoç...

...Nuk deshi mamaja,
Nuk deshi im atë,
S'deshi gjithë dynjaja,
-Na pastë më qafë!...

Do më nisin nuse
Të xhumanë në drekë
Falëmë të lutem
Në më do vërtetë.

Vellar do më vënë,
Eja te më shoç'
Të më japësh zemër.
Të më ngushulloç !...

Hiç mos e bëj veten.
Ngrehu dhe në valle
Merak mos më mbetet
Eja që të ç'mallem . . .

Të më vish në dasëm,
Më të mos më vish,
Mos më hedhësh gurë
Përsipër çalisë! . . .

Mos më vish më kurrë
Po qe se më do;
Bëje zemrën gur,
Mos më turpuro ! . . .

Dl. 27.01.1991

# Pashë një ëndërr të çuditshme

*Pashë një ëndër shumë të çuditshme:*
*Sikur binte një shi turpi nga qielli;*
*Sikur nxënësit kurvëronin me mësuesit,*
*Dhe si pasojë — ministrat me barrë ngeleshin ( ?! )*

*Ca pleq e plaka, që s'u ecte në seks,*
*Visheshin priftërinj e hoxhallarë;*
*Kush kishte hatër-rregjistrohej murgeshë,*
*Po t'i jepje rrushfet sekretarit të parë . . .*

*. . . Ishte një ëndër e përçudnuar vërtet :*
*Qëndra e gravitetit s'qe nga lart-poshtë,*
*por nga poshtë- lart*
*Dhe shefat, për t'u parë shalët vartëseve të*
*bëshme,*
*S'bënin sikur u binte zali,*
*Po ngjiteshin në tavan !*

*Në fakt, sipas ëndrës, kjo s'qe alogjike*
*Sepse njerëzit rrinin ulur kokëposhtë*
*në kariket këmbëpërpjetë . . .*
*Një grua plot tule desh të futej në një shishe ;*
*[illegible] vilhet tre presidentë !*

. . . Unë, i dehur-xurxull, bridhja nëpër rrugë
Zbathur ; këpucët në duar i kisha marë.
Dhe bërtisja : - poshtë fisnikëria hajdute !;
Rrofshin e bëfshin prokopi brashnjarët ! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Ishte një ëndër plot makth - më besoni ;
Por më kuptoni, ( dhe pse kam turp ta them )
Në fakt më zbaviti e më çlodhi,
Se pashë gjëra që s'i shohim në jetë ( ?! )

Dt. 2.07.1991

# O miq, së fundi për ne erdhi ora ...

. . . Ja më në fund, për mua erdhi ora,
Gjëmo tam-tam, trumbeta ulurin ;
Ç'përmban prej Ambrakie, plus Kosova,
Kan qënë dhe do të jenë Atdheu im ! . . .

Se ato vise janë thjesht shqiptare ;
Dikur i kanë pasë thirrur "Pellasgji ";
. . . Atje kemi stërgjyshërit nëpër varre,
Dhe s'lëmë të na i bëjnë lesh e li ! . . .

Kudo ku je, ngrehu në këmbë, shqiptar,
Të shpjemë në vend ç'la Zoti me senet ;
Dhe pse, të mundurit, ne s'do t'i heqim zvarë,
Si greku Akil — viktimën e vet ! . . .

O miq, së fundi, për ne erdhi ora,
Trumbeta si sirena ulurin :
– Ç'përmban prej Ambrakie, . . . plus Kosova,
Kanë qënë dhe do të jenë Atdheu ynë !

v. 1991.

# Paris dhe ju kryeqytete . . .

Paris dhe ju kryeqytete,
Dëfreni, qeshni cak më cak
Dhe nuk mendoni veç për vehte,
Përderisa unë prej jush jam larg . . .

Harboni, diqji ' në mistere,
Ejfelë, store, pjellori, . . .
Harbutëri është çdo merveje
Dhe perlë çdo harbutëri . . .

. . Ka shekuj që është prenotuar
Avjoni im për në Paris,
I konstruktorit të mbaruar
Dino Çiço, por . . . s'lëviz ! . . .

Por do të vijë, në qoftë e thënë
" Perpetum mobile ", n'u dashtë . . .
- Ç'do ndjeheni nën timen këmbë
Vikingë, saksonë, e galë, e baskë ??! . .

Me plazhe, porte e spiranca,
Dhe valse — mizëri bri Sene,
Ooo, ç'gene do t'u ndez, në ardhça,
Që s'dini as vetë në i keni! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Paris dhe ju kryeqytete,
Dëfrehi' qeshni cak më cak . . .
Dhe nuk kujtohi' veç për vehte,
Sikur të jem një vit — dritë larg !!!

Dt. 4.07.1992

# Jam tepër vonë për të qenë i vonuar...

Jam tepër vonë për të qenë i vonuar,
Ndaj nuk nxitoj kurrsesi...
Kam frikë se s'ka frikëra për të më frikësuar,
Tek shkoj nëpër shi ...

Mbijnë karafilë jetimë, të hidhëruar
Nga plasat e asfaltit të zi...
...Jam tepër vonë për të qenë i vonuar,
As kthehem, as ngutem, as rri ...

Dt. 23.05.1992

# O miqtë e mi , ju po ikni !...

O miqtë e mi, ju po ikni,
Në dhera të huaj, përtej ;
Dhe zemrën mua ma kripin
Detet që çani me velë ! . . .

. . . Po ikni në botën e lirë,
Me qejfe, femra, para, . . .
. . . Të gjitha janë për njerinë,
Që puna e lind, dhe . . . e ha ! . . .

.......................................

Po ikni, po hidheni tutje,
Do hiqni, dhe mall do t'ju vijë . . .
Do piqni gëzime e dufe, . . .
Dhe ndoshta, dhe vetë lumturinë ! . . .

..........................................

O miqtë e mi, ju po ikni,
Po mua më duhet të rri :
Nuk dua që maji të mërzitet,
Kur të vijë dhe mos gjejë njeri ! . . .

Dt. 29.04.1992

# Kur gjërat qenë të gjitha të verdha : ..

Kur gjërat qenë të gjitha të verdha . . .,
Ose të paktën -hiqeshin sikur qenë të tilla :
Gjethet- të verdha, rrugët-të verdha.
njerëzit — të verdhë . . .
Kur gjërat qenë të gjitha të verdha . . .
Një vajzë e vogël flokëverdhë - Vjeshta,
U skuq në fytyrë si lulëkuqe,
Se gati sa s'i shpëtoi :
"po jam dhe unë !? . . ." . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Kur gjërat qenë të gjitha të verdha, . . .
Ose të paktën, hiqeshin sikur qenë të tilla . . .
Kjo vajzë e vogël flokëverdhë- Vjeshta :
Zotin luste,
Që dimri të vinte sa më parë, ta thinjte ! . . .

v. 1992

# Përpjekje për të kuptuar...

. . . Njeriu, kur lind,
Ka fytyrën e baltës që e pjell. . .
Pastaj;
Në shteglofté në të tjera baltra,
Mundohet t'u japë atyre
Fytyrën e tij. . .
Prandaj është e vështirë detyra e burrit ! . . .

v. 1992

# Kult për Gjirokatrën

Gjirokastra për Shqipërinë,
Ka qënë përherë Amerikë :
Ju jep raketën,
Dhe kundër-raketën, njëkohësisht . . .

Dhe që ta qortoni,
S'keni aspak të drejtë :
Atë që dëshironi
Ajo përherë ju jep ! . . .

- Në daçi raketë,
Në daç — kundër — raketë ! . . .
. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .
Të jesh gjirokastrit,
Nuk është aspak e lehtë :
- Ose asimilohu,
Ose largohu vetë ! . . .

.................................

*Gjirokastra për Shqipërinë,*
*Amerikë do të jetë përherë,*
*Sa dhe vetë Amerika,*
*Para saj, është një. . . fermë! . . .*

*v. 1993*

## Kur mbi asfaltin e zi unë do të shtrihem...

Kur mbi asfaltin e zi unë do të shtrihem,
Dhe ju me këmbë do të më shkelni,
Mos m'i kurseniu hapat mua . . .
Pse, a do mund të zhytem thellë ?! . . .

Që kur pikat e shiut
Nën fanfara bubullimash të vallzojnë,
Të mos mund të më shkulin !. . .

o. 1992

## Himni i Fantinës së bukur

Fantinë e bukur, e meruar,
Nga bukuria që më ke;
E poseduar, eksploruar,
Nga tufa shefash – një kope !...

Askënd s'mallkon në botën prore
Veç bukurisë që të ra short;
Ti-pre e epsheve hamshore,
Zhan D' Arkë zyrash gjithë komfort !...

.........................................

Ka mbetur mbrapa feminia,
Ku ne të dy lozëm pa faj...
Një shkencë si arkeollogjia,
Fosile muresh që ringjall;

Sikur të mundte ta rigjente
Të lashtën, tënden femini;
Nën baltën, hirin, nën skeletet, ...
Ti- Trojë e vogël, shkrumb e hi !...

... Fantinë e bukur, e meruar,
Nga bukuria që më ke ;
Rrjepur e ndukur, përçudnuar
Pa pikë mëshirë, si hergjele ! . . .

v. 1992

# Në zemër kush e ka një peng...

Ai që s'ka një peng në zemër
Gëzimin s'di ta çmojë;
Në dashuri, kush nuk ka humbur,
Nuk di të dashurojë!...

Buzët që heshtin të përthara
Dhe prein me durim
Gëzime, halle — ç'del përpara;
Gëzojnë respektin tim!

Me hidhërime kush është rregjur,
I bukur është në shpirt,
Ka shumë të flasë — andaj rri heshtur,
I flasin vetëm sytë ...

... Në zemër, kush e ka një peng,
- ka një liman, një barkë;
Me velën shqyer nëpër erë,
Fundoset pakë nga pakë ...

Dt. 29.05.1992

## Shtëpi, mos ikni ! ...

Shtëpi, mos ikni,
Mos u çvendosni
Ju lutem ! ...

Natën,
Para se të bie të fle,
Të gjithë më mbushin mendjen :
- Hi i qetë se asgjë s'do të ndodhë...
Por unë e ndjej
Çvendosjen tuaj,
Të ngadaltë por të sigurtë
Më të ngadaltë dhe më të sigurtë
se e kërmillit...

...Shtëpi, mos ikni;
Merrini lotët e mia dhe bëjini themel,
Thomëni çfarë s'ju mjafton,
Shtëpi, mos ikni,
Pjalmi s'është trill,
- Nuc ! ...

Dl. 6.4.1993

# Botë që kaq keq je shkretuar...

Botë që kaq keq je shkretuar,
Je çdukur, je bërë shkrumb e zhur . . .
E plotë ekziston veç në mua,
E larmishme siç ishte dikur ! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Kjo gërmadhë - ëndëron të vithisel,
Po ka shekuj që s'po e përmbush ;
Ky trëndafil — pjesërisht i mirisur,
Do konkludojë, ndoshta më në fund ?! . . .

Botë që kaq keq je shkretuar,
Je çdukur, je çbërë kaq mjerisht,
Në motet e të ardhmes së shkuar
Prapë tek unë mbaron dhe nis ! . . .

v. 1992

# Çizmet

Unë isha i vogël
Kur binte shi;
Me pallto në kokë
Dhe çizme mavi.

Uji hynte nga vrimat
Në çizmet e mi'
Po unë prapë i vishja,
S'm'i dinte njeri !...
........................
Tani që po thinjem
I veshur, i mbathur,
Kur moti zë ngryset
Sërish ndjej të mardhur

Dhe lutem në heshtje
Që mos të bjerë shi,
Dhe pse s'lagem vetë,
Po çizmet mavi !...

Më duken me vrima
Gjithë çizmet e botës,
Po s'ja them njeriu,
E mbaj brenda kokës . . .

Pse ndjehem i vogël;
Ç'është kjo noti ? !
. . . O palllo mbi kokë,
O çizme mavi ! . . .

v. 1992

# Kambizëm

Merrini këmbët dhe duart e mia të [illegible],
Merrini këto mushkëri
Që rastësisht ndodhen brenda brinjëve të mia
Merrini, merrini këto lukse pa kuptim !...

Merrini këto harrime bjonde,
Këto shpresa të përdhunuara
          dhe këto mëlçi ;
Dhe jepmëni shpirtin tim që është mes tuaj,
Ose që ma kanë vjedhur të tjerët — s'di se si ...

Jepmëni dy turpe dhe një zgjebe,
I këmbej me njëzeteshtatë ndershmëri ;
Polici financiare — qepe !
Kambizmopitek, arkeokurvëri !...

Ju jap tre qeveri, një pederast,
          dhe dashnorin e gruas së presidentit
Vetëm për dy kopsa këmishe,
Dhe një ulurimë dymijë decibell ;...
Ngrijeni vehten tuaj prej veshi
Dhe vareni praparicën në çengel !...

. . . ............................................

.... Kam sloqe të tëra me ëndra fallco
Që inflacjoni i ç'vleftësoi krejt;
Jua jap në shkëmbim të një palaçoje
Që të shesë në parlament . . . peshq ! . . .

Dt. 21.08.1992

# Kaq herët ty të nisëm nuse ! ...

( Ja kushtoj mbesës sime,
Erjola Xhani – vdekur e mitur )

Kaq herët ty të nisëm nuse,
Pa pajë, dhe të heshtur krejt ;
Të mbyllëm në kuti të kuqe,
Dhe nuk të hodhëm riz, - po dhe ! ...
...........................................
Doktorë, spitalë, e infermjera,
Xhelatë më duken, dhe Makbethër ;
S'ndënje me ne as dy pranvera,
Dhe nuse shkon në botën tjetër ! ...

Dhe ime motër, për çdo drekë,
Kot shkon në çerdhe të të marë,
Se prë ty – është gjithmonë mëngjez,
Dhe dreka – kurrë s'do vijë, o xhan ! ...

v. 1992

# Çerek metro kub bejte

Një gjë e urrej,
Një gjë tjetër e dua,
Dua dhe urrej të njëjtën gjë ;
Dhe të njëjtën kënaqësi pothuaj
Ndjej gjithnjë! . . .

Çdo njeri është i mirë,
Ose i keq — s'ka rëndësi ;
Ne e bëmë të tillë,
Aspak vehtja e tij . . .

Nëse e bëmë të tillë,
Kemi nevojë për atë ;
Për vehten e tij
S'rron asnjë! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Ca gjëra i urrej,
Ca të tjera i dua,
Dua dhe urrej të njëjtat gjëra !

Dhe ju, s'më ngel hatri
gjykomëni mua,
Që bëra mirë ose që keq bëra ...
Bëni mirë ose keq,
Për mua s'ka rëndësi,
Ju dua të tërëve, gjithsesi ...

Edhe ju : mos duani gjithnjë
të njëjtat perëndi ! ...
As për urrejtjen
Mos vini tapi ! ...

Dt. 16.05.1992

# Sa e mirë do qe bota pa shefa !...

Sa e bukur do qe bota pa shefa !...
Bota është dashuria jonë ;
Bota s'do urdhëra e shkresa ;
Liria ne kurrë s'na mjafton !...

...Nëse duhet patjetër të ketë shefa,
Dhe nëse duhet që rregullat t'i zbatojmë ;
Së paku, mos t'u qeshim, atyre pleshtave,
Dhe kurrë mos t'i dashurojmë!...

Shefi, po të dojë, bën "çudira" ;
Të bën mirë, ose po të dojë,
-të bën keq ...
Nga halli — bëhemi servila,
Me njëri-tjetrin, s'tregohemi të drejtë...
.................................................
Sa e mirë do qe bota pa shefa,
Pa përgjegjsa të ç'do lloji e shkalle !...
Se, nëse i kanë të këqija të metat ;
Vyrtytet i kanë të poshtra fare !...

Dl. 23.05.1992

## Fryn erë e mallit, e mosgjetjes ...

Jam në atdheun tim,
Rroj në shtëpinë time,
s'jam i mërguar
dhe prapë s'çmallem me asgjë;
Me asgjë të vendit tim.
Kam mall, kam mall, kam mall . . .
Sikur të isha shtatë dete kaptuar,
Sikur me shekuj atdhenë mos ta kisha parë . . .
. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .
Mos vallë atdheu është mërguar nga unë ?
Mos vallë unë jam mërguar nga vehtja ?
Mos vallë duhet të nisem për udhë
Që të shpëtoj nga ... mosgjetja ? ! . . .

Dt. 8.09.1992

# Një prostitutë

Matilda, ti je prostitutë ;
Vetëm kur je e tillë, ti je e ndershme ;
Të ra shorti të lëvrosh këtë fushë,
Dhe nga ky shkak të nënçmojnë nerëzit ! . . .

. . . Në fakt, do ish' e drejtë të të përqeshnin
Po të shiteshe ajo që s'je ;
. . . Kurvëria jote është e ndershme,
Po ta krahasosh me ç'fshehim ne ! . . .

v. 1992

# Himne qenore

Marshon me zulme qenëria
Dhe nën një marsh sublim,
Lëpirësira të lëpira,
Lëpin, pështyn, lëpin . . .

Po mua, s'di qysh urtësinë
Ma dha një racë hyjnore :
Ta mëshiroj dhe këtë herë
Orgjinë e pistë qënore . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

-Lavdi qënore qënërisë,
Le të marshojë pa pre ;
Pa' të, fytyrë e shoqërisë
E mangët do të qe ! . . .

Dl. 11.06.1992

# Rininë time kur varrosa...

Rininë time kur varrosa
Nuk pata pranë as miq, as shokë,
As lulevjola, barbarosa,
Dhe po ashtu s'pati as lotë . . .

Për ngushëllime nuk më erdhën
Se s'pat' njoftime, funeral;
Veç supeve të mi të dredhur ;
Rinia ime vdiq ngadalë ! . . .

Askush, askush s'e mori vesh
Nga njerëit që ka kjo botë
Rinia ime dha shpirt thjeshtë ;
I hodha sipër dhe të ftohtë . . .

Dhe përbetime, nostalgjira
E kotë është fare që të bëj ;
Se më e mira nga të mira,
Rini e vet është pa gjithkënd !

. . . Ju shoh i heshtur, buzëplasur ;
Ashtu më shihni edhe ju,
Kush nuk rrëfehet — është i pasur,
I madh, i thellë — posi një muzg . . .

Ndaj me pak brymë e me pak diell,
Unë do të puth a do lëngoj, . . .
Dhe shpirt im i pa rrëfyer,
Më mirë të ngelet është besoj.

- Mos u mundoni, mos denjoni
T'i shisni si një flirt të parë
Gjithë dashuritë që më drejtoni ;
- Me kohë rinia ju është urarë ! . . . ,

Më mirë të ulemi pa fjalë,
Pa fjalë të shihemi në sy
Dhe jetën tonë si një cigar
Ta thithim thellë dhe unë, dhe ti . . .

E di gjithçka që ti s'ma thua,
Ti di gjithçka që unë s'ta them ;
Ndaj heshtjen duke respektuar
Më je më pranë- më pranë të jem !. . .

. . .Rininë time kur varrosa
Nuk pata pranë as miq, as shokë ;
Me ' të — një copë tokë plehërova,
Dhe ai pleh akoma ngroh !. . .

Dl. 20.12.1992

# Mësoje gjuhën e gënjeshtrës

Mësoje gjuhën e gënjeshtrës
Dhe i sinqertë mos ji aspak,
Të drejtën thuaja veç vehtes,
Se ndryshe bëhesh qesharak ...

... Gjykatësit – foli veç për drejtësinë,
Do të dëgjojë me një vëmendje fallco,
Do mendojë : mëndja e ka lënë të zinë ;
Ose do thotë: kujdes – është dhelpër dinake ! ...

Këpucarit bëni muhabet këpucësh ;
Tregëtarit – foli për tregëti ;
- jepu të drejtë ! ...
.............................................

Megjithëse me shpirt do të përbuzin ;
Për ty do flasin me respekt ! ...

... Dhe gruas – do, s'do – përbetoju
Për dashuri bashkëshortore ;
S'ka ilaç : tradhto dhe tradhtoju,
Fshehtaz – konform normës shoqërore ...

*Dhe kriminelit e garipit*
*T'u paç për krime - të nderojnë;*
*Megjithëse të urrejnë nga shpirti,*
*Dhe pse s'u thua e s'ta thonë! ...*

.........................................

*Përdor veç gjuhën e gënjeshtrës*
*Në jetë, që mos të turpërohesh;*
*Veç nën jorgan — kur të jesh vetëm*
*Qa fshehura nga pak, se çlodhesh ...*

*Dt. 14.05.1992*

## Omik,
## me bryl ti mos më vra !...

O mik, me bryl ti mos më vra,
Kij pak mëshirë kur shtyn;
Unë të hap rrugë - kalo vëlla,
Dhe lermë në hallin tim.

I lig je boll dhe shpirt kënetë,
Dhe të mjaftojnë këto,
Të kesh sukses, të çash në jetë,
S'të kam zili – kalo !...

Kandidaturë s'vë kundra teje
Askurrë, për asnjë gjë;
Gjithçka mund të të duhet – bleje,
Se ke para – ç'do më ?!

Po mos kërko të gjithë të themi
Atë që thua ti;
Nëqoftëse pas midesë të vemi,
Nga halli, o i zi !

.............................................

*Megjithatë me bryl mos ura,*
*Kij pak mëshirë kur shtyn ;*
*Mendo : të ishe fukara,*
*Do haje brrylin tim !...*

*Dt. 27. 06. 1992*

## ...Sikur të kisha kohë!...

Sikur të kisha kohë të shmangja nxitimet,
Po s'kam kohë as të kthejë kokën pas ; ...
... S'kam frikë nga kriminelët, po nga ndërgjegjja ime,
Që herë më vret, e ... herë e vras ! ...

Dt. 11.06.1992

## I vetëm, qoshesh birrarie...

I vetëm, qoshesh birarie
Veç një kafe " me pak ", unë pi,
Dhe rri, mejtohem veresie
Pa lekë, pa miq, pa perëndi !...

I pasur në varfërinë time ;
Po kur së paku ke atdhe,
Arrin që me përfytyrime
Të posedoç atë që s'ke !...

.................................

I heshtur, cepash birarie,
Unë veç duhan e kafe pi ;
I lirë jam në përfytyrime,
Ato s'mi rrobëron njeri !...

v. 1993

# Vargje të pa preçedenta

... Pa dal të shoh njëherë ç'kam shkruar;
Them mos ta ngas ç'kam thënë mirë;
Fytyrën time të harruar
E vara mbi një muzg, në brinjë...

Mëlçinë e shpretkën i dhashë hua,
Ca rrahje zemre — me qira;
Jam bej i marrë, i kalëruar.
Vatani im — treqind dynja !...

M'u rrit një mjekër dje - nga malli;
Gjakos mamuzesh gjogun tim.
Nuk pyes nga ëngjëlli dhe djalli
Bujar jam sa një suferinë!...

Gjersa u linda — jam i lirë...
S'ma ndal dòt gjogun asnjeri;
Varet nga unë të ngel i tillë:
( Mbi dhe, nën dhe — nuk ka rëndësi

Vërtitem lutje me vërvimë,
Se jam i ligë — të liga dua,
Se rroj e vdes për bukurinë,
Në vdeksha — ngjallem më një krua !...

.........................................

O miq mos ma përpiqni llafin,
Se jam vezir i çmëndur — beg ;
Sakën dhe se më del inati,
Ndaj gjogut mos m'i zini shteg !...

v. 1993

# Dy pika loti nga tuajat . . .

Dy pika loti nga tuajat
Janë dy pranga për mua.
Dhe unë pa pranga s'jam i lirë . . .
Ejani, shtrohuni në mua,
Kur sendet harrojnë të rrinë . . .

Dhe kur tërmetet të ndrojtur
Si adoleshentë dridhen lehtë,
Vetëm tek unë, i pambrojturi
Të mbrojtur do jeni, krejt ! . . .

. . . Dy pika loti nga tuajat,
Janë dy pranga për mua,
Dhe unë pa pranga s'jam i lirë . . . ;
Hekurat e qelisë janë në mua :
Janë kafazi i kraharorit tim ! . . .

Dt. 27.02.1993

# S'di në jam i parakohshëm a mbrapa botës ?!

Sikur s'tonoj me botën rrotull,
Ku s'janë të gjithë të mirë ;
Ku ka shpirtngushtë dhe miopër,
Ka dhe të pafytyrë . . .

Sikur të qenë aq të paktë ;
Të qenë një e dy,
S'do t'i përmendja, në fakt
Në këtë poezi ! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Njeriun, jeta e mëson
(Edhe i ndershëm qoftë )
Kur ka nevojë — të llaston,
Pa të ofron një gotë, . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Po pse, e drejta mos arrijë,
Të dalë gjer në fund ? ! ..
Pse tjetri — të qeshë me pahir,
Kurrizin , pse ta ulë ? ! . . .

. . . Ka tipa aq mirë të përshtatur,
Dhe aq kameleonë,
Që s'shkulen me njëqind plenume,
Rreth " poçes ", qarkullojnë.

. . . Ka njerëz, që gjithnjë përpiqen
Të japin sa më pak ;
Që japin me lugë të kafesë,
Dhe marrin me lopatë . . .

. . . Mos vallë veç unë qenkam ters,
( Dhe është në rregull bota ),
Që dhe mbi plan punoj — sa mundem,
Dhe pse s'më rritet rroga ?! . . .
. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .
Stonoj me botën rrethrrotull,
Prandaj mejtohem unë :
Debilat, fuksat dhe miopët,
Sikur janë shtuar shumë! . . .

v. 1998

# Në vendin tim nuk ka bjerjozka...

Në vendin tim nuk ka bjerjozka,
As stepa me borë e thëllim, . . .
Megjithatë, në rrugët, sofrat,
Jemi të gjithë pak Eseninë! . . .

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Dhe pak këtu e pak atje,
Dhe pak kështu e pak ashtu,
. . . Ky Sergejushka përmbi dhe
U derdh, e mbriti gjer këtu . . .

Në vendin tim nuk ka bjerjozka,
As stepa. po prapë ka thëllim, . . .
Dhe të këndosh dimrin në sofrat,
Mbase s'mjafton një Esenin ! . . .

V1993

## Frito të njoma...

Frito të njoma,
Për të mos thënë asgjë...
... Gjithçka është e rimtë,
Kudo,
-Shkatërroni në heshtje !...

Dt. 6.04.1993

## Mos mundje shkretëtirse . . .

. . . Të kam burgosur diku tutje,
në një kështjellë në shpirtin tim ;
Atje s'bën punë as kartë a lutje,
As telefakset nuk arrijnë ! . . .

Të përshëndes sopesh të largët
Të subkoshjencës sime bosh ;
Kaq mizorisht të kam përplasur
Dhe s'mundem më të të ç'burgos !

Do duheshin mijëra ranishte
Dhe mijëra detra të kaptosh,
Për një qafim a prekje gishtash . . .
Po a ja vlen aq larg të shkosh ? ! . . .

Pse marrëzisht të adhurova,
Ndaj po të kyç në shpirtin tim ;
Falmë që dot nuk të harrova,
Falmë që ta privoj lirinë ! . . .

*Ballsam t'u bëftë shkretëtira*
*E sopeve të shpirtit tim;*
*Për ty do bëj gjithë harakirat,*
*Kërkomë gjithçka, por jo lirinë...*

.............................................

*Salut, pra ti, gjithmonë e largët;*
*Oaz në rërën pa mbarim,*
*Pandehmë e shtrenjtë, mistral i dashur,*
*Që s'mund të ta lejoj lirinë !...*

*Dt. 1.12.1993*

# Ç'trishtim është të jesh kundëradmiral i braktisur...

Anije prej letre ne bënim at'herë
Dhe i lëshonim në gjol,
Me frymë i shtynim, kur nuk frynte erë,
E dikurshmja Vjolë!...

.................................................................

Por pellgun prej kohësh tani e kanë tharë,
Pallate të reja kanë ngritur;
Kurse ti je larg. - në të tjera krahë,
Dhe flota ime është mbytur!...

v. 1993

## Në shpirtin tim ulurijnë njëqind sirena ...

Në shpirtin tim ulurijnë njëqind sirena,
Ulurijnë pa bërë zë...
Ditën s'i ndjej nga zhurmat e tjera,
Po natën, - thomë ni si të flë ? ! ...

Dt. 29.01.1993

# Vajzë me flokët e bukur, të artë...

ajzë me flokët të derdhur, të artë,
muamë: ç'të duhen flokët e bukur?!...
- Preji, preji dhe flaki mbi asfalt,
Për inat të bolës matufe!...

- Preji flokët e arta,
-shëmtohu;
Gjërat e bukura — ti e sheh, s'kanë vlerë;
Ne shkulëm shpirtrat tanë dhe në rrugë i hodhëm,
Ose, ( ç'rëndësi ka ), na i shkulën të tjerët!...

Gjërat e mira, të bukura, fisnike,
S'janë veçse një limonadë;
Që na merren neve —
Për t'ju shuar etjen të ligve,
Ose për t'ju falur atyre një ...orgazmë!...

Vajzë, ç'i do sytë e bukur, të kaltër;
Nxirri me gishtat e tu, - mos nguro! ...
Si tha dikur Dhiogjeni i plakur:
"Më mirë e shoh botën pa 'to!" ...

Dt. 20.07.1993

# Tek porta jote kokën kthej...

Tek porta jote kokën kthej
Dhe pse prej kohësh ti je larg,
Qenushi plak më s'po më leh,
Për ty çdo ditë thinjet në prag !...

Të pret të vish, qeni besnik
Prej viseve ku ti mërgon,
Dhe i penduar e i trishtë,
Sikur me sy më ledhaton ...

Ai, që dikur më vërsulej,
S'më linte xhamin ta trokas;
Tani, si Odise i dukem,
Që vonë jam kthyer në Itakë...

Dritare, dyer, gjithë munxosur
Dhe Penelopa vetë ka ikë;
S'e di se ku harbon me mtonjës,
Pa më dhënë rast të jem Uliks !...

v. 1993

## 1 + 1 = 2

Voza të lagura,
Nga një shi,
 që s'bie;
Ëndërra të përvëluara,
 si kurva të virgjëra,
Që militojnë
 fisnikërisht,
 për penis, ...
.................................
- Kjo është jeta! ...

Dt. 4.04.1993

## Teuta , ti ishe një epos...

... Teuta, ti ishe një epos
Me Troja dhe Akila, plot;
Dhe ne- ( n + 1 ) Homera të vegjël rrotull,
Të tërën s'të kënduam dot !...

Dt. 11.09.1993

# Këndoj për një shelg

Këndoj për një shelg
Të blertë buzë lumit,
Që më ngushëllonte
Kur gjatë ty të prisja,
Po kurrë s'erdhe ti !...

.....................................

Kaloj pas ca kohësh
Dhe shelgu ish' plakur ;
Dhe ta ngushëlloj
S'kam se si...

Salut, pra, për shelgun
E tharë buzë lumit,
Që para kohe u plak, ...
...Në krahët e qetë të dremitjes e gjumit,
Të mirët flijohen pa mnshkak !...

Dt. 7.06.1993

## Unë rri këtu e bëj vjersha...

Unë rri këtu dhe bëj vjersha
Në vendin tonë fukara ;
Fishkëllen në shpirtrat tanë vjeshta,
Ç'të hajë për drekë, nuk ka !...

I sëmurë, unë vë e heq vargje :
Njëzet qindarka një varg...
Po vargjet bukë s'më japin,
S'më japin as drekë, as darkë!...

Po të shesësh sapunra e kremra,
Fiton shumë më tepër para,
Se sa po të shkruash poema ...,
( Bile, të bëjnë budalla !... )

Megjithatë s'heq dot dorë,
Dhe pse në gazeta s'i shpie,
Shkruaj vjersha për këtë tokën tonë,
Dhe miqvëve ua lexoj veresie ...

*Nga duhani kam kollë, a nga vjershat ? ;*
*- Po ngelem tërë jetën brashnjar . . .*
*Kështu si unë — vetëm vjeshta,*
*Këmbëzbathur gjezdis në pazar ! . . .*

*v. 1993*

# Kadare , mos u bëj më i madh ...

Kadare, mos u bëj më i madh - është e kotë :
Fama tënde, tani Botën ka marrë . . . ;
Je ngjitur aq lart – dhe të duash – s'zbret dot,
Në degën më të hollë, mu në majë ! . . .

Unë veles sime i kam vënë detyrë,
Po a do mund premtimin ta mbaj ?? . . .
Që mos të të thur asnjë himn,
Veç të të qortoj, të të shaj ! . . .

S'i dua servilët që u përgjërohen
Gjenive – gjer në pikë të sabahut ;
Të qortoj, Kadare, se më ngjan e harrove
"Djalin që puthi vajzën e Aqif Kashahut " . . .

Irena, Ejfelë, . . . pak shi mbi La Manshë, . . .
Madhështira dhe Parizë të lagur, . . .
Hanin e fëminisë, - qysh e braktise,

-i marrë ;
Ku era tund tabelën : " Hapur " ? ! . . .

.............................................

*Kam qenë dhe unë student në Tiranë;*
*I shkelur nga malli — jam asfalt i zi! ...*
*Për "rrugët ku ke bërë ndonjë marrëzi"?!...*
*s'ke mall?!...*
*Po "për rrugët ku s'ke bërë asnjë marrëzi"?!...*

*Tek "Rrugë e Dibrës" — shtyhen kur del buka;*
*Tshesarët shajnë çdo udhëheqës, lirisht, ...*
*Tashmë është thinjur me kohë Mira Struga,*
*"Vajza më e bukur e ish - Kampit Socialist".*

.......................................................

*Kadare, mos u bëj më i madh — madhështia,*
*S'është asgjë — nuk të fal lumturi ...*
*Le të thotë bota — gjithë; - mos dëgjo,*
*-mba vesh mua,*
*Që s'kam qenë kurrë i madh — ndaj e di!...*

*Do vij të të gjej në Francë, në hotelet;*
*Na pret Rosinanti poshtë, ...*
*Në Gjirokastër — poshtë Kalasë,*
*te shpella,*
*Suzana për ty, derdh lotë!...*

*v. 1993*

# Lulëzojnë hidhërimet e mia !...

Lulëzojnë hidhërimet e mia,
Shkëlqejnë lotët e mi;
Të pashoqe, të pa arrira,
Smeralde të zeza, mavi, . . .

. . . S'më thoni dot : s'janë të bukura ! . . .
Si farfurijnë o Zot;
Si xixëllonja, si flutura,
I shoh, i puth, . . .s'çmallem dot ! . . .

Të urta, të ndershme, - si bija
Jetime, që s'dinë të turpërojnë, . . .
I nis me duart e mia,
Pa bukë, kur venë në shkollë ! . . .

.........................:.................

Shkëlqejnë hidhërimet e mia,
Lulëzojnë lotët e mi,
Ndokënd e kaplon zilia;
S'ja mbush synë lumturia e tij ! . . .

v. 1994

# Që kur zura mikeshë mospërfilljen...

Që kur zura mikeshë mospërfilljen,
Hoqa dorë nga të qenët i madh;
Më dhimbsen kopetë e gjenive,
Bëjnë- ç'bëjnë- vijnë tek unë, që t'i fal!...

..............................................

O i lumtur: - thuajmë ç'është lumturia,
Ose, më mirë, mos ma thuaj;
Se do kuptosh që ...asgjë s'ke kuptuar,
Dhe do më bësh të vuaj!...

v. 1994

## Kori i të papërtypërve mirë

*( Këngë e kënduar nga barku i Ciklopit )*

Erdhi kohë e mbrapshtë: - çmimet u ngritën;
Ciklopët pleq, dhëmbë çatallë
Ngaqë s'paguajnë dot dentistët,
Na kapërdijnë gjysëm të gjallë !...

Dhe ne -sëmurë nga marrëzia,
Paturpësisht derdhim dhe lotë !?...
Se ç'vojtje heq ciklopëria,
As duam që t'ja dimë, o zot !

Ndërkaq; tek tretet për njerëzinë,
Rrëfen ciklopi urtësisht,
Po i del zëri si gërhimë,
Se i mosmundur është, zaif:

-Kam qenë Hektor dhe Ifigjenë,
Priam, Parid dhe Menela, ...:
Po kam shumë punë – tash Polifem;
Më lusni – po s'kam kohë t'ju ha !...

*. . . Uliks, më vonë duku njëherë,*
*Ndoshta do mund të bëj diçka . . .-*

*Ç'të na bëjë më Ciklopi i mjerë;*
*Ne as mendojmë që një bark ka ! ! !*

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

*Erdh' kohë e mbrapshtë : çmimet u ngritën,*
*Do lekë dentisti, domosdo ;*
*Ciklopët — fukarenjtë dhëmbëprishur,*
*Po na përtypin shkel e shko ! . . .*

*Dt. 7.04.1994*

# Mos mundje për t'u shprehur më saktësisht...

-Ju të liq savanash,
Që m'i përzutë mendimet
Dhe lopët m'i bëtë të
qajnë...
A s'e dëgjoni
Qysh zanafilla tymrash
Bënë vragë prapëseprapë ?!...
..................................
Urre, nuk them mos urresh.
Kur është e pashmangshme.
Por s'mund të urrejmë veçse vehten.
kur tek të tjerë e shohim ...
..........................................
-Hajt, bimëni harezë kumore,
Dhe flashkni,
Zambakë të qëllimtë
urtësisht !...

Shtator 1994

# Pasazhe në heshtje sa s'nuk bëhet, ose mosarsye transversale...

-Kaloni në heshtje
Mbi parvazët e së vërtetës . . .
Binda, qau
mospërfillëse,
Me një barazpeshësi nokturne,
Më tepër se sa për një pezullim të mundshëm
akujsh;

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

-S'ka sipas meje,
Profilaksi kloroforme !

. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

Përtej epokës së pendimeve,
At'herë kur ju qetë spermë apo grusht,
Dashuria s'mund të quhet më foshnjë jetime,
Të një kambjal – dhe ti, mos e firmos,
në mundsh ! . . .

Dt. 3.08.1994

# Diskorancë Nr 2

Ishe, ishe përherë shumë e bukur, . . .
Po më pak e bukur –
kur ishe e lumtur ( ?! ) . . .
. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .
Më vjen keq të të bëj të qash ! . . .
Po keq dhe mos të të bëj të qash ?!:.

-Ec, pastaj - zotin vesh ta mbash ! . . . -

v. 1994

## Larg rri Betina nga mua ...

Larg rri Betina nga mua ,
Dhe unë prej Betinës rri larg ,
Se gjërat e shtrënjta - po i poseduam ,
Të paqëllimtë bëhemi në çast ! ...

v. 1994

# Vjolës

Vjola,
Dashuria ime e brishtë,
Mermer i dashur,
varrezë që më rilind, ...
jetimore shirash !
-Po pse kështu ???

Diellin do ta zë me shkelma ,
Ngaqë s'më dha mundësi të të kem !...

v. 1994

## Kujtoj, kujtoj një muzg pranvere...

Kujtoj, kujtoj një muzg pranvere,
Kur trupi yt , i bardhë - hata ,
Ma ndriste dhomën gjysëmterre
Sa njëqind·llamba të mbëdha !...

... Dhe them të plas me vehten time ,
Se - ndërsa prapë në krahë të mbaj ;
Sikur s'po shoh aq shintilime ,
- Si një kandil i zbehtë në vaj !...

..O bukuria ime të është zbehur ,
O sytë e mi janë bërë miopë,
O mijëra muzgje , që kanë rrjedhur , ...
...Se ndryshe -ç 'është ky paradoks ?!...

..............................................

Kujtoj , kujtoj një muzg të bruztë ,
Kur trupi yt i bardhë - myzhde ,
Ma mbushte jetën e vakumtë
sa njëqind stina me hare !...

v. 1994

# Diskorancë Nr. 1

Ishe e bukur pa arsye,
E bukur , definitivisht !...
..................................
Unë dua gjërat pa motive,
Prandaj të desha marrëzisht !...

v. 1994

# Estelës

...Të adhurova , kilometrash larg ;
Siç adhurojmë një tufë vetëtimash , ...
Pa dashur t'i kemi në duar aspak
Këto lule të hatashme shirash ! ...

Dl . 28 . 9 . 1994

# Pse kaq shumë modest u bëre ?! ...

( Ja kushtoj kushuririt tim , djalit të shkëlqyer Ali Peçi , vdekur në lulen e rinisë. )

... - Pse ,pse kaq modest u bëre ,
Duke mos ekzistuar më ;
Duke shkëlqyer me mungesën tënde,
Përgjithnjë ! ? .....

v. 1994

## Prelud për Astjanaksin

Sikur të kishte njëmijë Troja
dhe Astjanaksa - vetëm një ;
Por Astjanaksat janë miljona ,
Një Trojë e vetme nuk i nxë ! ...

.........................................

Me mijëra Troja le të kishte ,
Dhe le të qenë të urara krejt ,
Veç Astjanaksi sytë mos mbyllte ,
Se balta ende s'po e tret ! ...

v. 1994

## Shtatori erdhi i gjymtuar...

*Shtatori erdhi i gjymtuar*
*Me spondilozë dhe verem ;*
*Ndonjë të shtune të harruar*
*Dëgjohet ndonjë dasmë e mjerë !...*

*...Shtëpisë unë kthehem mbrëmjes vonë*
*Dhe tej orkestrën tek dëgjoj ,*
*Më bëhet të qaj për dasmorët :*
*- Sa pak gëzim që posedojnë !... -*

*t. 1994*

## *Më jep kujtim një puthjen tënde ...*

*Më jep kujtim një puthjen tënde ...*
*Qysh lashtë e kam pasë hak ta marr,*
*................................................*
*T'i shpiem gjërat nëpër vënde,*
*Duke i lënë ... ashtu siç janë ! ...*

*v. 1995*

# Se ti kishe kaçurrela të bukura ...

... Se ti kishe kaçurrela të bukura ,
As bjonde , as brune , as të kuqe ,
po si okër...
Mos i pre kaçurrelat e bukura ,
Vajzë e vogël !...

Kaçurrelat e tua ; si me pak brymë ,
me pak ikje...
Dhe natyrisht , me pak vetmi ;
Leji ashtu siç i kishe ,
Mos i ngjyej , as mos i pri !...

.......................................

- Mos i nga kaçurrelat e bukura ,
Mos na ler kështu : pa vetmi ;
Nga ligësia , të paputhurat,
Mos i ngjyej , as mos i pri !...

v. 1995

## Salut , Seneka !

*I thanë Argjirosë :*
*" Festivali s'do bëhet më në Gjirokastër ... "*
*- Po mirë , tha Princesha ;*
*Unë s'dua që të tjerët të thonë :*
*" Si gjithmonë, do bëhet atje ... ",*
*Po : " pse s,do bëhet atje ??! " ...*

*Dt . 28 . 8 . 1995*

## Ekskluzive

Gjërat që mua më përkisnin ,
Mi posedojnë të tjerët....
Dhe tashti ato ,
Kërkojnë të çlirohen nga ... liria e tyre ;
Duke më lypur mua
Një çikëz robëri...
... Po ç'tu jap unë,
Robëria s'më mjafton për vehte ?!...

Di . 11.7. 1995

# Boll

Unë do kridhem
Në trishtim
Boll u deshëm ,
Boll u zimë ! ...

Boll punuam ,
Boll u ndamë ,
Boll duruam ,
Boll qamë !

U urryem ,
Ndenjëm bashkë ;
Boll - dhe brënda ,
Boll - dhe jashtë ...

Unë do zhytem
Në harrim ;
Boll gëzuam ,
Urimë !

.....................

Boll atë , e
Boll këtë,
Boll - gjithçka
Dhe hiçigjë !...

Boll dhe " kundra ",
Boll dhe " pro ",...
Boll dhe " boll " - i ;
Absteno !

Dt. 2..9.1995

# Të kisha një gërmadhë të bukur...

Të kisha një gërmadhë të bukur
Për vehte dhe për shpirtin tim ,
Me myshqe , barëra , ... ku një flutur ,
Të gjente një grimasë harrim ! ...

Me gjurma duarsh të padukshme ,
Të kisha një gërmadhë të shtrenjtë ;
Një akëduk me harqe puthjesh
Ta rindërtoja prapë me mend ...

.........................................

Të kisha një gërmadhë fisnike
Me mure , foshnja , korifej , ...
Nën baltra e kërkoj për shpirtin ;
Po nuk e gjej , po nuk e gjej ! ...

Dl. 23. 3. 1995

# Varjant për Penelopën

Penelopa s'ishte grua namuzqare ;
Odiseun s'e priti aspak ;
Të vështirë ,ajo s'e kishte fare :
Mlonjësve në verë, t'u hidh' farmak ! ? ...

Penelopa ishte grua e pëlleshme :
Don' të mbretëronte në Itakë ,
Dyzet princër t'i sillte rreth vehtes ,
Që me rradhë , t'i ndërronte në krevat ! ...

Asnjëherë s'u kthye Odiseu ;
Penelopa nuk e priti kurrë ,
Bardi plak , pa dashje , na gënjeu :..
(Se mos kishte sy , ai, mor burrë ! ? ...)

v. 1995

# Këngë e re për vendlindjen...

Vendlindja ime - djep i kurvërive të reja ,
të shëndetshme,
Mushti i zjarrtë që në fuçi s' mbyllet dot !
Gjysëm të groposura , gjysëm legale,
Po përjetësisht të paudekshme :
Zhvillimin sjellin -
duam - s' duam !...

Vendlindja ime -
mëmë e kurvërive të solme,
Femër që pjell,
pamvarësisht kush e mbars !...

Aureolë vetmish ,
Që prapëseprapë ndjehen vetëm...

Unë - nga balta gjysëm i dalë,
Për të shpëtuar gjysmën time ,
Pranoj gjysmën tjetër ta gropos!...

.......................................

*Vendlindja ime - xhelat dhe viktimë,*
*Plagë e thellë , me qelb e gjak ,*
*- s'di se si ...*
*Më mirë se unë , të kanë kënduar*
*plot të tjerë ,*
*po kështu si unë , s'të këndon njeri ! ...*

*Dt. 17. 2. 1995*

# Unë do t'i them tim biri...

...Unë do t'i them tim biri:
- Gjykomë ti, o bir; në mirë a keq kam bërë,
- se unë, gjithë jetën,
Kam ndërtuar dy gjëra
Që shkatërrojnë njëra - tjetrën!...

v. 1995

# Letina moj ! ...

Vajza më e vogël e klasës ,
E urtë ,...
e pakët ,
- si Gishtoja ...
E pa propozuar nga djemtë ,
E pa puthura ! ...

Ti dole më e bukura ,
Ti dole më e bukura ,
Ti dole më e bukura ! ...

Dt . 29 . . . 1996

# Gromësima të thjeshta ...

I bukur është qielli ,
Gërrhima dhe tërfili ...
Të bukura janë gëlbazat ,
E bukur është mospasja ...

I bukur është ministri,
sperma dhe turshitë , ...
Të bukura janë prangat ,
Po më e bukur është vdekja !
A - ja - ja ! ...

Dl . 6 . 4 . 1996

## Empas për gjërat që s'shpjegohen

Ju lumturitë e mia i zhupitni,
I shtrydhni , ju pini gjakun ,
i shkelni me këmbë
Konform të gjitha normave urbanistike
Dhe ligjeve të parlamentit ,
- bile u ngrini dhe këngë ! ...

... Dhe kur shëtitni në rrugë të lumtur
- kuaj e pela të bukura ,
mëzëri;
Prapëqëprapë shpirtin ma këpusni
Se të vockla janë tuàjat lumturi ! ...

Dt . 2.9.1995

## Forca e gjërave, ose vjershë e lënë përgjysëm...

Vargani i gjërave që kërkojnë derman,
Endet,,
    përdridhet,
        përplaset...
Ku e ku me të qetë,
Po ku e ku me vërvimë...
Dhe ndodh të na plandosë neve
Ndonjë hallkë e tij, ndonjë gremçë,
Përdhe të na bythosë...

Dhe ne - ca të përgjakur,
Po gjene optimistë,
Se ja : na theu njërin krah,
        - po kemi tjetrin;
Na preu një këmbë,
        - po kemi patericën...
Na preu njërën kokë,
        - po kemi kokën tjetër...

-Ooo , po këtu duhet ndërprerë vjersha.
Se na del një kokë tepër !!!?

.....................................

_ Ç'do kjo kokë këtu ?
Ose : ç'u bë koka ?!...
Dale , se s'na dalin kokat,
Olele koka !...

Dt. 9. 1. 1996

# Rreziku i mbulimit

Bie rërë mbi viset e mia ,
Mbi trenat , mbi xhamat , mbi makinat ,
- bllokohen shinat
Bie rërë mbi rrugët , mbi pemët
U shqyen nga puna skuparet ,
mekanikët , hidraulikët ...
Bie rërë mbi enët , mbi çarçafët
-gratë u çanë duke pastruar
Dhe s'kanë gjë në vijë ...
Bie rërë nga qielli
- siç duhej të binte shi ose breshër;
Makar të binte shi , borë a breshër...
Po përkundrazi bie rërë ,
- sikur shkunden hënat !
U mbulua gjelbërimi , lulet ,...
Bie rërë mbi pjanot mbi qivuret
- s'hapim dot një varr
Se mbulohet menjëherë
Pa arritur të kallim mehitin ...

Bie rërë mbi foshnjat ,
mbi Djaloshin Guximtar ...
mbi trotuaret,
- s'shëtisim dot -u mbuluam !...
Bie rërë mbi rapsodët , mbi eposet ,
mbi dashuritë ,
Poetët u hapën bythsh , u ra infarkt ,
- bie rërë mbi muzat ! ...
... Sahara , Sahara , Sahara ! ...

Dt . 29. 7. 1996

## Ku t'i kërkoj rrënjët e tua , Parti ?!

"...Mutra dhe shira !..." -
thënie e të marrit Stavri Maçoku.

... - Ku t'i kërkoj rrënjët e tua , Parti ?...
Ti - ti - ti,
ti - ti - ti ! ...
Nuk kam punë, nuk kam shtëpi;
Ti - ti -ti, Ti - ti - ti !...
Pse na bëtë lesh e li !...

Ku t'i kërkoj rrënjët tuaja, partira ?...
Me daulle , me borira ,
Nëpër mutra , nëpër shira !...
Cila është më e mira ?!...
Cila do na bëjë çudira ?...

Cilës do t'ja vëmë kurarin ?
Cilës parti ja pamë hajrin ?...
Ndër arapë - zgjidh më të bardhin ?!...

v. 1997

# Gra

Gra që veni e vini në punë,
- kot sa veni e vini në punë !...
Me këmbë , - se s'keni lekë të paguani urbanin ;
një orë të veni - një orë të vini ...
Që bëjnë sikur ju paguajnë ,
Po dhe në ju pagofshin ,
- kot sa t'ju paguajnë !...

Gra të velura nga dashuria...
Të velura në atë masë ,
-saqë kurrë s'keni dashuruar !...
Gra që pillni mëmëdhera sakate !...

O fytyrat tuaja të pudrosura mjerisht
me sfilata pëllëmbash...
Po dhe ato që s'hanë pëllëmba ,
Ëndërrojnë që së paku ... të hanin pëllëmba !...
Kurrë s'u shpartallua për së mbari shpirti juaj
Nga një stuhi për së mbari ,
Nga një braktisje për së mbari !

*... Kemi nevojë për një ikje ...*
*Kemi nevojë për diçka që të na prekë ;*
*Po s'na prek asgjë :*
*As dhimbja , as gëzimi ! ...*
*......................................*
*Gra të velura , të lumtura*
*- gjer në përdhosje ;*
*Të nderuara përtej çdo caku*
*- gjer në ç'nderim ! ...*
*... S'shkruaj dot vjersha për ju ,*
*Se më dhembin strofat !!!*

*Dl. 6.7.1996*

## PERMBAJTJA FAQE


| | |
|---|---|
| Fotografia | 4 |
| Bukuroshja e autobuzit | 6 |
| Vrull pune në klubin e komitetit ekzekutiv | 8 |
| Rruga Budi | 9 |
| Harmonika | 10 |
| V.F - LP | 12 |
| Unë kam shumë vendlindje | 13 |
| Mbi varrin e ushtarit | 15 |
| Ninullë për shefin | 17 |
| Deas | 19 |
| Pyes njerëzit në vjeshtë | 20 |
| Ty të mbuluan fletët moj lëndinë | 22 |
| Eskiz për një mbrëmje | 23 |
| Ikja | 24 |
| Vogëlsira... | 25 |
| O Francë , ti je një Atdhe | 26 |
| Sot kam ditëlindjen | 27 |
| Dita kur u ndava përfundimisht me të dashurën | 28 |
| Ndanë udhe u shtriva | 29 |
| Lamtumirë , buzëqeshje që s'mbërdhini | 32 |
| Mos i shiko yjet ... | 33 |
| Pikëllim | 34 |
| Gjyshja ime | 35 |
| Suva | 36 |
| Unë jam djalosh i poezisë... | 37 |
| Gomarët e fshatit bënë festë ... | 39 |
| Unë e di : Do më kujtosh e përmalluar | 40 |
| Jam shkatërrimtar i dashurive të mia ... | 41 |
| Troja | 42 |
| Motiv i moçëm dasme | 4[illegible] |
| Pashë një ëndërr të çuditshme | 4[illegible] |
| O miq , së fundi për ne erdhi ora ... | 4[illegible] |
| Paris dhe ju kryeqytete ... | 4[illegible] |

Jam tepër vonë për të qenë i vonuar 50
O miqtë e mi , ju po ikni ! ... 51
Kur gjërat qenë të gjitha të verdha ... 52
Përpjekje për të kuptuar ... 53
Kult për Gjirokastrën 54
Kur mbi asfaltin e zi unë do të shtrihem... 56
Himni i Fantinës së bukur 57
Në zemër kush e ka një peng ... 59
Shtëpi , mos ikni ! ... 60
Botë që kaq keq je shkretuar ... 61
Çizmet 62
Kambizëm 64
Kaq herët ty të nisëm nuse ! ... 66
Çerek metro kub bejtje 67
Sa e mirë do qe bota pa shefa !... 69
Fryn erë e mallit , e mosgjetjes ... 70
Një prostitutë 71
Himne qenore 72
Rininë time kur varrosa ... 73
Mësoje gjuhën e gënjeshtrës 76
O mik , me brryl ti mos më vra ! ... 78
Sikur të kisha kohë ! ... 80
I vetëm , qoshesh birrarie ... 81
Vargje të papreçedenta 82
Dy pika loti nga tuajat ... 84
S'di në jam i parakohshëm a mbrapa botës ?! 85
Në vendin tim nuk ka bjerjozka ... 87
Fruto të njoma 88
Mos mundje shkretëtirse ... 89
O trishtim është të jesh
kunderadmiral i braktisur ... 91
Në shpirtin tim ulurijnë njëqind sirena ... 92
Vajze me flokët e bukur , të artë ... 93
Tek porta jote kokën kthej ... 94
1 + 1 = 2 95
Teuta , ti ishe një epos .... 96
Këndoj për një shelg 97

Unë rri këtu e bëj vjersha 98
Kadare, mos u bëj i madh ... 100
Lëzojnë hidhërimet e mia ! ... 102
Që kur zura mikeshë mospërfilljen ... 103
Kori i të papërtypurve mirë 104
Mosmundje për t'u shprehur më saktësisht ... 106
Pasazhe në heshtje sa s'nuk bëhet.
ose mosarsye transversale ... 107
Diskorancë Nr 2 108
Larg rri Betina nga mua 109
Vjolës 110
Kujtoj , kujtoj një muzg pranvere ... 111
Diskorancë Nr 1 112
Estelës 113
Pse kaq shumë modest u bëre ?!... 114
Prelud për Astjanaksin 115
Shtatori erdhi i gjymtuar ... 116
Më jep kujtim një puthjen tënden ... 117
Se ti kishe kaçurrela të bukura... 119
Eksluzive 120
Boll 121
Të kisha një gërmadhë të bukur ... 123
Varjant për Penelopën 124
Këngë e re për vendlindjen ... 125
Unë do t'i them tim biri ... 127
Letina moj !... 128
Gromësima të theshta ... 129
Empas për gjërat që s'shpjegohen 130
Forca e gjërave ,
ose vjershë e lënë përgjysëm... 131
Rreziku i mbulimit 133
Ku t'i kërkoj rrënjët e tua , Parti ?! 135
Gra ! 136



Ka lindur më 1961 në Qytetin e Gjirokastrës. Pasi mbaroi shkollën e mesme "A. Zeneli", vazhdoi studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Gjeodezi, ku u diplomua më 1986. Ka punuar si inxhinier gjeodet në Hidrocentralin e Banjës në vitet 1986 - 1987; pastaj në ekspeditat rilevuese kadastrale në malësitë e rrethit Gjirokastër (1987 - 1990).

Ka punuar si inxhinier gjeodez në Z. U. P. (Zyra Urbanistikës dhe e Projektimit) Gjirokastër etj. Edhe sot punon në profesionin e tij si inxhinier. Ka shkruar vjersha qysh në fëmijëri, por ka botuar pak: në gazetën "Pararoja", "Zëri i Rinisë", "Studenti", etj...

Ky është vëllimi i tij i parë.